



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.52

Prishtinë, më 19.2.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Xhevahire Izmaku Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Shkumbin Demaliaj dhe Jelena Bontiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Besjana Bajrami, Ekonomia Online; Valbona Bytyçi, Kosova Post; Arbenita Murmullaku, RTK-Radio; Erdinit Petroceri, praktikant VV; Vlora Selimi, Arberesh.info; Loren Hyseni, KDI; Fitore Ademi, RTV 21; Naim Jahaj, këshilltar PSD; Bardha Smajli D+ praktike, Nehat Dervishi, OSCE; Dardane Neziri, Koha Ditore; Edita Kusari, EUSR/EUO; Blerta Bejtullahu, EUSR/ EU Office.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-152 për Pronën Publike;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-176 për Hetim Parlamentar;

5. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO162/18;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-152 për Pronën Publike;

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 06/L-152 për Pronën Publike, i cili tha se është shumë i rëndësishëm, duke përmendur edhe disa vërejtje në lidhje me bartjen e pronësisë, tek dhënia e qirasë, dhënia e koncesioneve tek partneriteti publiko-privat. Ndonëse është mirë i shkruar, nuk mund të lejohet të ketë hapësira për interpretim, duke pohuar që projektligji duhet t'i adresojë të gjitha shqetësimet që kanë pasur ndër vite, ndërsa kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Hajdar Beqa, tha se është një nismë e mirë e propozuesit për këtë projektligj. Jemi duke e shqyrtuar në parim, prandaj ka vend për plotësime dhe ndryshime, që do të mund të bëhen në fazat e mëtejme dhe kërkoi nga anëtarët ta përkrahin në parim.

Xhevahire Izmaku,tha se është i mirëseardhur si projektligj ngase 10 vjet pas pavarësisë, ka pasur dilema se kujt i takojnë kompetencat në këtë çështje që është shumë e rëndësishme. Pra, për herë të parë jepen kompetencat aty ku duhet, Njësisë për Administrimin e Pronës në kuadër të Qeverisë, por edhe të pronës së komunës për të cilën flitet në nenin 17 të këtij projektligji. Nëse paraqiten dilema, janë disa ligje të tjera që e plotësojnë si Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Ndërmarrje Publike, Ligji për Shpronësim të Pronave Publike, që janë kompetencë e nivelit lokal dhe shtoi se projektligji është i mirë të përkrahët në parim.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni me 4 vota për dhe 4 abstenime, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet, në parim, Projektligji nr.06/L-152 për pronën publike.

Për miratimin, në parim, ishin: Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Bilall Sherifi, Xhevahire Izmaku, ndërsa abstenuan: Arben Gashi, Korab Sejdiu, Albulena Haxhiu dhe Sami Kurteshi.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private;

Albulena Haxhiu, kryetare, propozoi që shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, të shtyhet për mbledhjen e radhës, për disa çështje që kanë mbetur për tu shqyrtuar.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se anëtarët e Komisionit u pajtuan që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Projektligjit nr.06/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Projektligjit nr. 06/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar. Ajo tha se janë mbajtur dy grupe të punës, ku janë ndryshuar 4 nene. Në amendamentin 4, janë 2 propozime, që kanë të bëjnë me raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor.

Raporti përfundimtar, sipas znj. Haxhiu është që t'i shkojë prokurorisë sepse nëse një komision hetimor është themeluar për të evidentuar një çështje, raporti duhet të shkojë në Prokurori, prandaj edhe prokuroria është e obliguar të njoftojë Kuvendin për ecurinë hetimit, ndërkohë që fjalën ia kaloi z. Hajdar Beqa, për të arsyetuar propozimin e tij.

Hajdar Beqa, tha se kam propozuar që të hiqet neni 4, duke pasur parasysh, që Komisionin Hetimor e voton Parlamenti. Nëse mbetet neni 4 i projektligjit, atëherë është shkelje kushtetuese sepse pushtetet janë të ndara dhe prokurori i shtetit nuk i raporton Kuvendit për ecurinë e hetimit. Po ashtu, edhe hetimet mund të dëmtohen nëse ky nen mbetet në projektligj.

Kryetarja, tha se absolutisht nuk e dëmton hetimin kështu siç është sepse edhe një individ kur dorëzon një kallëzim penal në prokurori, prokuroria tregon se a ka nxjerr aktvendim për nisjen e hetimit, pra tregon për procedurat që është duke i ndjekur, në raport me një kallëzimin penal.

Në këtë rast prokuroria e ka për obligim ta njoftojë Kuvendin se çfarë ka bërë me raportin e Komisionit Hetimor, i cili i është dorëzuar. Pra, a ka nisur hetimet apo jo, sepse ka vlerësuar se nuk ka gjetur shkelje dhe kjo nuk ka të bëjë aspak me ndërhyrje në sistem të drejtësisë.

Arben Gashi, tha se komisionet hetimore kryesisht nisen prej opozitës dhe normalisht opozita nuk e ka numrin e mjaftueshëm për ti miratuar raportet e veta, as në Komision dhe as në Kuvend. Ndër tjera, shpjegoi lidhjen logjike institucionale, por problemi kryesor tha është tek raporti i paaprovuar, në të cilin e kemi në dy komisionet hetimore, ku një komision nuk ka nxjerr raport ndërsa tjetri nuk ka e ka aprovuar dhe raporti i paaprovuar nuk i procedohet seancës.

Mëtej Gashi tha, se raporti i paaprovuar në Komision, duhet ti procedohet seancës, por me rekomandim negativ sepse Komisionet janë trupa rekomanduese dhe seanca vendos për apo mosaprovimin e raportit të Komisionit Hetimor. Pra, nëse prokurorisë i dërgohet si njoftim nuk e dëmton procesin, por kthimi i njoftimit mbrapsht, përderisa nuk është kallëzim penal sepse këtu ngatërrohet koncepti i komunikimit ndër institucional.

Kryetarja, tha se me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit, nuk pati mundësi ndërhyrjeje në ligjin bazik sepse nuk e lejon rregullorja, andaj dhe nuk kemi ndërhyrë në nene tjera, përveç kësaj faze.

Frashër Krasniqi, tha se sa i përket nenin 4, nuk është shumë thelbësore se as praktikisht dhe as formalisht nuk e prek aspak punën e pavarësisë së gjyqësorit, ngase krejt çfarë po kërkohet, është që të njoftomi mbi ecurinë hetimit të raportit, që e ka përgatitur Kuvendi dhe që ia ka dërguar prokurorisë.

Hajdar Beqa, tha se po kërkohet të njoftohemi nga prokurori i shtetit mbi ecurinë hetimit dhe si mund ta trajtojmë në seancë këtë njoftim. Më pas propozoi që neni 4 të hiqet sepse ligjet nuk bëhen për tu komplikuar qytetarët apo në këtë rast sistemi i drejtësisë, por bëhen për tu lehtësuar.

Frashër Krasniqi, propozoi që në nenin 4, paragrafi 9 i projektligjit për ndryshim-plotësimin e Ligjit për hetim parlamentar, fjalët “ecuria e hetimit”, të zëvendësohet me “ecurinë e procesit”, në mënyrë që të hiqen dilemat për ndërhyrje në sistem të drejtësisë.

Sami Kurteshi, tha se pajtohem që formulimi i nenin 4, paragrafi 9, nuk është i formuluar mirë, por propozoi që “prokurori i shtetit informon Kuvendin në lidhje me veprimet e ndërmarra”. Njëkohësisht propozoi që të bëhet një hulumtim, në lidhje me, jo me vendet e rajonit, por me vendet të cilat kanë më shumë përvojë dhe i kanë të rregulluara më mirë Hetimet Parlamentare sepse do ti kontribuonte shumë këtij projektligji.

Frashër Krasniqi, pajtohet që të bëhet një hulumtim parlamentar, por të shikohen edhe praktikata e vendeve të rajonit, duke pohuar se edhe në këtë projektligj është marrë bazë Ligji për Hetim Parlamentar të Republikës së Shqipërisë. Më tej, tha se ky projektligj është më i mirë sesa ligji aktual për Hetim Parlamentar.

Bilall Sherifi, tha se ky projektligj nuk ka ndonjë ndryshim substancial në mënyrë përmbajtjesore të trajtimit të lëndëve, të cilat do të dërgohen si informatë nga Kuvendi. Në bazë të Ligjit për prokurorinë e shtetit, prokuroria exofficio është e detyruar të ndjek çdo rast që konsiderohet që është kryer një vepër penale, ndaj përmes kësaj nuk është se kemi shtuar ndonjë instrument më tepër se kaq. Përmes kësaj i është dhënë një instrument prokurorisë që raporti hetimor i cili votohet nga Kuvendi, të trajtohet më seriozisht. Po ashtu tha se ndoshta po bëjmë dëm sesa po rregullojmë diçka sepse në raport të progresit mund të cilësohet si ndërhyrje në sistemin e drejtësisë, prandaj duhet të rregullohet asisoj, që mos të interpretohet si ndërhyrje në sistemin e drejtësisë.

Korab Sejdiu, shprehu shqetësim në lidhje me nenin 57, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për interpretim jologjik, që po e pamundëson punën Kuvendit, e cila ka të bëjë me moslejimin në ndërhyrje në ligjin bazë, përmes një projektligji që propozohet për ndryshim dhe plotësim. Ndërkaq kjo po e promovon hartimin e disa projektligjeve, kur krejt qëllimi i Kuvendit është që të hartohen ligje që janë sa më të kapshme, më të lexueshme dhe më të zbatueshme për qytetarin. Sejdiu propozoi që Komisioni të hartojë një vendim për të gjithë dhe ti japim një interpretim logjik kësaj dispozite, ku lejohet ndërhyrja edhe në ligj bazik tek projektligjet që janë në procedurë të ndryshimit dhe plotësimit.

Sa i përket i projektligjit, që është shumë e rëndësishme, i është dhënë opozitës të ketë një anëtar më shumë sepse pozita çdo hetim parlamentar do ta pengonte. Po ashtu, tha se amendamenti 4, propozimi B, mos të përkrahet, por të përkrahet propozimi A i nenit 4, me një ndryshim që të hiqet paragrafi 3 sepse nuk mund të kërkohet në hap informacion nga prokurori i shtetit, në lidhje me ecurinë hetimit. Edhe pse ideja nuk është që të kërkohet në çdo hap informacion, por mund të keqinterpretohet. Në fund z. Sejdiu propozoi që propozimi A në amendamentin 4, paragrafi 1 në fund të fjalisë të shtohet “edhe ndonjë institucioni tjetër, që e vlerëson Komisioni Hetimor” përveç këto që janë listuar në këtë paragraf sepse paraqet kufizime.

Hajdar Beqa, propozoi “Raporti me rekomandime i miratuar në Kuvend, ti dërgohet për njoftim Qeverisë së Kosovës, Prokurorit të Shtetit, Auditorit të Përgjithshëm, Agjencisë Kundër Korrupsion dhe Institucionit të Avokatit të Popullit” dhe paragrafët 2 dhe 3 të amendamentit 4, propozimi A, të hiqen.

Kryetarja, tha se nuk ka ndërhyrje sepse nuk është fjala për komplet ecurinë e hetimeve në vazhdimësi, por fjala është për ecurinë e hetimit në fazën fillestare, se çfarë aktvendimi ka nxjerrë, po fillon apo nuk po fillon hetimi.

Pas diskutimeve, kryetarja i hodhi në votim propozimet, ku propozimi i z. Hajdar Beqa nuk mori përkrahje, ndërsa propozimi si më poshtë u përkrah.

1. Raporti me rekomandime i miratuar në Kuvend, i dërgohet për njoftim Qeverisë së Kosovës, Auditorit të Përgjithshëm, Agjencisë Kundër Korrupsion dhe Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ndonjë institucioni tjetër, që Komisioni Hetimor e vlerëson të nevojshëm .

2. Raporti me rekomandime i dërgohet Prokurorit të Shtetit.

3. Prokurori i Shtetit njofton Kuvendin për ecurinë e procesit.

Pas diskutime Komisioni me 4 vota për, 1 kundër dhe 3 abstenime, nuk e përkrahu raportin me amendamente të propozuar të Projektligjit nr.06/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, i cili kthehet për shqyrtim sërish në grup të punës.

5. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO162/18;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO162/18 , në lidhje me neni 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që pas paragrafit (8) të shtohet paragrafi (9) “ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”.

Arben Gashi, ndër tjera pati vërejtje procedurale në lidhje me mënyrën e votimit të amendamentit kushtetues, ku kërkoi që të respektohet Kushtetuta, për mënyrën e votimit edhe në komision, duke pohuar se procedurat e seancës për votim duhet të vlejnjë edhe për Komision.

Pas diskutimeve Komisioni me 7 vota për, ia rekomandoi seancës për miratim amendamentin Kushtetues.

6. Të ndryshme.

A. Kërkesa për interpretim ligjor të nenit 24 të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe neni 58 të Ligjit për Kundërvajtje;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim kërkesën për interpretim ligjor të nenit 24 të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe neni 58 të Ligjit për Kundërvajtje.

Por, pas një mosmarrëveshjeje që pati kryetarja me anëtarët e komisionit, për çështje që nuk lidhen me rendin e ditës, kryetarja e lëshoi mbledhjen dhe kryesimin e mbledhjes e vazhdoi zëvendëskryetari z. Hajdar Beqa.

Komisioni, shqyrtoi shkresën e z. Dëfrim Gashi, drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit, me numër të referencës: 10/128, për dhënien e interpretimit ligjor të nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe të nenit 58 të Ligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje. Lidhur me këtë, vlerësoi se:

Nuk është në fushëveprim të komisionit, interpretimi i dispozitave të ligjit, mirëpo në rastin konkret nuk bëhet fjalë për interpretim, por për sqarim, për faktin se dispozitat e theksuara e kanë qartësinë e duhur juridike dhe në asnjë rrethanë nuk mund të shkaktojë huti te zbatuesi.

Komisioni, pasi analizoi dispozitat e Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe të Ligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje, vlerësoi se nenet 56 dhe 58 të Ligjit për kundërvajtje nuk mund të shikohen ndaras, sepse këto dispozita përcaktojnë qartë kompetencën e organit kundërvajtës, në rastin konkret, Inspektoratit të Arsimit, si organ kundërvajtës, ka kompetencën për shqiptimin e sanksionit kundërvajtës, me gjobë deri në shumën që ka përcaktuar neni 56 i Ligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje. Për kundërvajtjet që tejkalojnë shumën e përcaktuar me nenin 56 (sanksionin kundërvajtës me gjobë), atëherë mund të iniciohet procedura e kundërvajtjes në gjykatën kompetente.

Kurse neni 24 i Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës nuk është në harmoni të plotë (brenda minimumit dhe maksimumit), që ka përcaktuar neni 29 i Ligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu